



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2024:028889

Datë: 06.02.2025

Numri i dokumentit: 06815503

C.nr.1157/24

GJYKATA THEMELORE GJILAN, gjyqtari Arben Xheladini, me bashkëpunëtoren profesionale Ronita Halimi, në çështjen kontestimore të paditësit I.N., nga fshati P., Komuna e Gj., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Mustafë Nuhiu avokat nga Gjilani, kundër të paditurve B.K., J.K., dhe N.J., që të gjithë me adresë të panjohur, me objekt kontesti vërtetimi i pronësisë, vlera e kontestit 1,805.00 Euro, jashtë seancës, më datë 06.02.2025, merr këtë:

AKTVENDIM

Konsiderohet e tërhequr padia e paditësit I.N., kundër të paditurve B.K., J.K., dhe N.J., me objekt të kontestit vërtetimi i pronësisë.

A r s y e t i m

Paditësi I.N., më datë 22.01.2024, ka paraqitur padi kundër të paditurve B.K., J.K., dhe N.J., me objekt kontesti vërtetimi i pronësisë.

Meqë në padi nuk ishte shënuar asnjë adresë e të paditurve, me aktvendimin C.nr.1157/2024 të datës 20.01.2025, paditësit i është kthyer padia për ta plotësuar me adresën e të paditurve, ashtu siç kërkohet me nenin 99 të LPK-së. Paditësi është paralajmëruar me pasojat ligjore në rast se nuk vepron sipas këtij aktvendimi.

Pas kontrollimit të shkresave të lëndës, gjykata ka konstatuar se përfaqësuesi i paditësit, aktvendimin e datës 20.01.2025, e ka pranuar më datë 22.01.2025, afati i ka kaluar, ndërsa në shkresa të lëndës e as në regjistrin SMIL, deri në ditën e nxjerrjes së këtij aktvendimi, nuk ka arritur asnjë parashtrësë.

Duke qenë se afati tashmë ka kaluar dhe paditësi nuk ka vepruar, Gjykata, duke u bazuar në nenin 102.3 të LPK-së, sipas të cilit "Do të konsiderohet se është tërhequr parashtrësja po që se nuk i kthehet gjykatës brenda afatit të caktuar, e në qoftë se i kthehet pa u korrigjuar, gjegjësisht pa u plotësuar, parashtrësja do të hedhet poshtë.", vendosi si në dispozitiv të aktvendimit.

Gjyqtari,

Arben Xheladini

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, pas ditës së pranimit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë. Ankesa, në kopje të mjaftueshme, dorëzohet në këtë Gjykatë.